



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 977/1 Prot.

Tiranë, më 06.022020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 16.01.2020)*

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të: kandidatit relator Alban Toro; kandidates ..., relator Dritan Hallunaj.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 15:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                      |                   |
|----------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami   | (kryetare)        |
| 2. Maksim Qoku       | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici         | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli      | (anëtare)         |
| 5. Brunilda Kadi     | (anëtare)         |
| 6. Dritan Hallunaj   | (anëtar)          |
| 7. Ilir Toska        | (anëtar)          |
| 8. Alban Toro        | (anëtar)          |
| 9. Brikena Ukperaj   | (anëtar)          |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar)          |

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.
2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.

**RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjorë për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të: kandidatit \_\_\_\_\_, relator Alban Toro; kandidatës \_\_\_\_\_, relator Dritan Hallunaj.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 16.01.2020.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët.

Siç jeni vënë në dijeni, sot janë në mbledhjen e radhës në rendin e ditës, janë tre çështje kryesore.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për verifikimin dhe kushtet e kritereve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatëve z. \_\_\_\_\_, relator i së cilit është z. Alban Toro, dhe zonjës \_\_\_\_\_, relator i të cilës është z. Dritan Hallunaj.

Ndërkohë që projekt-akti i dytë ka të bëjë me zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, "Për rregullat dhe procedurën e caktimit gjyqtar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme", në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë.

Dhe çështja e tretë është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të



përhershme”, dhe kemi të bëjmë konkretisht me kërkesën e ardhur nga Gjykata e Lartë, dhe ky projekt-akt është bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, pa humbur kohë, le të fillojmë me çështjen e parë. Një nga pikat e çështjes së parë e cila është: Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit zotit .

Për më shumë detaje i jap fjalën relatorit zotit Alban Toro.


*Alban Toro:* Atëherë, faleminderit!

Më herët, me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shpalljen e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë dhe ka bërë thirrjen për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e juristëve të spikatur për një pozicion të lirë që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës civile.

Me vendimin 182, 02.10.2019 nga ana e Këshillit është marrë një vendimmarrje tjetër me të cilën kanë filluar procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidat nga radhët e juristëve të spikatur për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë. Dhe për kandidatin për të cilin jemi duke folur është caktuar relator zoti Alban Toro.

Konform procedurës së verifikimit është filluar komunikimi me kandidatin dhe institucionet përkatëse. Nga ana e kandidatit është marrë konfirmimi që nuk ka patur asnjë shkak për përjashtimin e relatorit apo ndonjë anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe më tej është vazhduar pastaj me procedurat e tjera të verifikimit duke u dërguar shkresat përkatëse institucioneve të ndryshme.

Nga ana e relatorit janë verifikuar kushtet e kandidimit konform nenit 49 të ligjit për Statusin. Konkretisht, është verifikuar qenia jurist, me anë të së cilës është administruar dokumentacioni (nuk po i citoj të gjitha meqenëse e keni patur relacionin); është verifikuar përvoja profesionale për jo më pak se 15 vjet si avokat, profesor ose lektor i së drejtës; pasja e gradës shkencore në drejtësi, është marrë konfirmimi përkatës nga Ministria e Arsimit për “doktor shkencash” në shkencën juridike; është verifikuar mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit, nga hetimi i së cilës nuk ka rezultuar mbajtja e ndonjë posti politik. Gjithashtu është



verifikuar mbajtja e ndonjë pozicioni drejtues në parti politike gjatë 10 viteve të fundit. Dhe nga ky verifikim nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për mbajtjen e ndonjë posti drejtues në parti politike.

Më tej është vijuar me kritere sipas nenit 49, pika 2, shkronja a) e ligjit të Statusit. Konkretisht është parë nëse disponohet zotësia e plotë për të vepruar, duke e konfirmuar këtë fakt; shtetësia shqiptare gjithashtu; gjendja gjyqësore; disiplina në punë, nëse ka patur rekorde apo jo, nga e cila ka rezultuar nga të gjithë punonjësit ku ky kandidat ka punuar nuk ka rezultuar me rekorde negative në kuadër të disiplinës në punë; nuk ka qenë anëtar apo bashkëpunëtor apo i favorizuar nga sigurimi i shtetit përpara vitit '90. Gjithashtu nuk ka qenë as bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete, konfirmuar kjo me shkresat përkatëse nga organet ligjzbatuese.

Më tej është vijuar pastaj me verifikimin e kriterit të pasurisë, konform nenit 49, pika 5 e ligjit të Statusit, ku është disponuar edhe raporti i ILDKPI-së, nga i cili ka rezultuar në përfundim se: Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Më tej është vijuar me kriterin e figurës, me verifikimin e kriterit të figurës, sipas nenit 49, pika 5, e ligjit të Statusit. Dhe nga verifikimi në këtë kuadër, nga institucionet ligjzbatuese, nuk ka rezultuar probleme në lidhje me figurën.

Pra, nga gjithë situata e verifikimit, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë mund të kompromentonte vijueshmërinë e procedurës për këtë kandidat, dhe më tej relatori ia ka kaluar Komisionit, i cili pasi e ka shqyrtuar nga pikëpamja procedurale, ka çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatit për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatit është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e vendimit 75/2019.

Në mbledhjen e datës 13.12. Komisioni duke konsideruar se procedurën dhe verifikimin për këtë kusht kandidimi ishin të plota, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu 6, i vendimit 75/2019, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidatit



dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 110, datë 09.07.2019, ose skualifikimin e kandidatit dhe përjashtimin e tij nga procedura e emërimit në këtë pozicion në Gjykatën e Lartë.

Kjo është në aspektin e verifikimit. Nëse keni ndonjë pyetje?

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!


Atëherë, nëse kemi ndonjë pyetje apo sqarim lidhur me përmbajtjen e raportit dhe dokumentacionit mbi të cilën është bazuar relatori, ju lutem.

**Fatmira Luli:** Atëherë, mund të na shpjegoni ku ka punuar kandidati gjatë periudhës 2004-2009? Me çfarë është marrë dhe me çfarë dokumenti provues vërtetohet, që ka qenë avokat, pedagog ose lektor i së drejtës, në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 1, të ligjit "Për statusin e gjyqtarit".

**Alban Toro:** Në periudhën 2004-2009 kandidati ka qenë asistent avokat pranë një studio avokatie i cila operonte në Gjykatën e Lartë greke, e quajtur kjo deri në nëntor të 2005. Në dhjetor të 2005 deri në shtator të 2009 asistenti ka vazhduar mësimdhënien në Universitetin Kombëtar të Athinës, pra ka ndihmuar një profesor duke kontrolluar dhe mbikëqyrur esetë e studentëve, dhe ka vijuar kërkimet shkencore në kuadër të mbrojtjes së titullit "doktor". Kjo provohet nga aktet që ai ka administruar në dosjen e kandidatit. Provohet nga të ardhurat të paguara për efekt të deklarimit të të ardhurave tek institucionet fiskale greke, gjithashtu edhe nga konfirmimet që i kanë dhënë supervizorët e tij ku ky ka operuar si asistent pedagog, apo në zyrën e avokatisë, nga zoti [ ] në kuadër të së cilës ai ka operuar për të mbrojtur apo përfaqësuar apo zgjidhur probleme të ndryshme juridike. Aktualisht aktet janë të gjitha në dosje.

**Fatmira Luli:** Atëherë, a mund të kërkoj ndonjë sqarim më tepër. A ka ndonjë dokument që vërteton se ka fituar titullin avokat dhe ka ushtruar aktivitetin si avokat në shtetin grek, tërë këtë periudhë nga 2004 në 2009?

**Alban Toro:** Pra të qenurit jurist, sepse kjo ishte pjesë edhe e përgatitjes që kisha bërë, ose do ta paraqes në vijim, për të konfirmuar faktin se përse relatori është dakord



dhe ka dhënë pëlqimin që ky kandidat të vijojë procedurën e mëtejshme, është pjesa e arsyetimit për këtë pjesë. Të qenurit jurist atje dhe punësimi si asistent avokat pranë një studio avokatie, në bazë të ligjit grek, përfaqëson shërbim avokatie. Është i njëjtë me shërbimin e avokatisë siç bën një avokat këtu. Pra, pjesëmarrja aktive, për efekt të kryerjes së disa shërbimeve avokatie në mënyrë aktive për shtetin grek, në legjislacionin grek, është e njëjta figurë siç ka avokati aktualisht që operon në Republikën e Shqipërisë.

*Fatmira Luli:* Që të ushtrojë këtë aktivitet duhet të fitojë titull. Pyetja ime ishte: A ka titull avokati në shtetin grek, për të ushtruar aktivitet avokatie? Ose titull tjetër që e ka ndihmuar të ushtrojë aktivitet avokatie? Sepse ne kemi, me ligjin tonë dhe me praktikën e punës, edhe asistenti merr një dokument ligjor. Ka dokument ligjor dhe asistenti. Nuk shkohet në asnjë gjykatë po s'pati një certifikatë që ti je asistent ose ti je avokat. Kush është titulli ligjor që ka zotëria me të cilin vërteton që ka ushtruar aktivitet avokatie dhe ka qenë avokat në shtetin grek?

*Alban Toro:* Atëherë Fatmira, më duket se u shpreha qartë që për legjislacionin grek...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Po citoje një çikë ligjin, citoje...

*Alban Toro:* Po do ta jap në...mos të rri ta riprodhojë 700 herë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Po do ta shikojmë dhe ne legjislacionin grek, që të japim një mendim.

*Alban Toro:* Legjislacionin grek shikojë dhe kryesisht Bruna, nuk është se...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Po jo, po tani ti je relatori, na refero që ta gjejmë atë legjislacion, të jetë edhe pjesë e dosjes.

*Alban Toro:* Meqenëse e ke merak, ta them tani.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Jo s'është çështje meraku...



*Alban Toro:* Se të thashë që është pjesë e arsytimit dhe do bëjmë përsëritje mbas përsëritje.


*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Se ne do marrim një vendim tani. Nuk kalojmë dot në arsyetim.

*Alban Toro:* Po jo moj, do ta arsyetojë unë këtë faktin e vendimmarrjes time, pse jam shprehur kështu.

Atëherë në Fletoren Zyrtare, Gazeta Qeveritare 208, 27.09.2013, Kodi i Avokatisë greke, në nenin 12, parashikon: Prezencën aktive dhe të pavarur të asistentit në gjykatën e shkallës së parë për çështje me objekt vepra penale, civile, administrative të lehta, në prokurori, në fazën hetimore, në gjykatat e paqes (kështu e kanë në shkallën e parë ata), gjatë diskutimit të konflikteve me vlera të vogla financiare. Pra, ushtrimi i profesionit nga asistent avokati, në mënyrë aktive dhe të pavarur për çështje të caktuar, në kuptim të ligjit për shërbimin e avokatisë greke, e ngarkon atë me të njëjtat të drejta dhe detyrime si subjekti që ushtron funksionin e avokatit.

Këtë rezonancë na e jep edhe ligji jonë, ku thotë që, tek neni 4, shërbimi i avokatisë: Avokati ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet, te pika ç), ndër të tjera ke: veprime të tjera të paparashikuara në legjisllacionin shqiptar ose në legjisllacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pra, në kuptim të ligjit grek, pjesëmarrja aktive për të kryer disa shërbime të caktuara, ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si një avokat, siç e ka këtu në Shqipëri, edhe pa pasur një licencë të veçantë. Këtë rregullim ka gjetur legjisllacioni grek. Dhe në kuptim të përvojës, relatori e ka konsideruar si përvojë në fushën e avokatisë sepse ka marrë pjesë aktive dhe zotëria është studio legale që përfaqëson vetëm në Gjykatën e Lartë. Pra, dhe atje ka disa ndarje të përfaqësimeve avokatore ku janë të përcaktuara, Gjykata e Lartë, gjykatat e apeliit dhe kështu me radhë. Pra, janë detaje që i ka ligji grek dhe ligjin grek mund ta gjeni të botuar në uebsajtin (*website-in*) e Ministrisë së Drejtësisë greke ose unë kam marrë përsipër t'jua sjell të përkthyer, por për fat të keq stafi s'e ka bërë, nuk e ka mundur dot ta përkthejë, do ta sjellë një moment të dytë, por jo në këtë seancë.



7

*Fatmira Luli:* ...të dëgjova. Por në çfarë neni të atij ligji thotë që s'ka nevojë për një licencë dhe një dokument të veçantë nga Dhoma e Avokatisë greke, që ai të punojë si asistent avokat ose si avokat? Në çfarë dispozite thuhet?

*Alban Toro:* Neni 12. Neni 12.

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Fatmira Luli:* Çfarë thotë neni 12?

*Alban Toro:* Neni 12 thotë që ai mund të bëjë përfaqësime në gjykatën e paqes, në prokurori, në fazën hetimore në prokurori.

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Fatmira Luli:* Pa titull?

*Alban Toro:* Pa titull. Bën punë avokatie.

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Fatmira Luli:* Bën punë avokatie pa pasur të drejtën për t'ia dhënë Dhoma e Avokatisë?

*Alban Toro:* Ia ka dhënë ligji të drejtën.

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Fatmira Luli:* Si ia ka dhënë ligji? Kush e konfirmon që ia ka dhënë ligji?

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin e më pas e rindez.)*

*Fatmira Luli:* Edhe në Shqipëri ligji thotë që asistenti të bëjë punë të thjeshta të avokatit, por titullin ia jep Dhoma Kombëtare e Avokatisë, i jep kartonin, i thotë je asistent avokat dhe shko puno. Pa këtë karton nuk shkon dot në asnjë gjykatë. Ky është titulli me të cilin e legjitimon, jo avokati që e shoqëron atë. Në këtë rast ajo dispozitë që cituat ju nuk e thotë këtë gjë. Thotë çfarë veprimesh kryen asistenti por jo kush e licencon asistentin.

*Alban Toro:* Kjo dispozita që përcaktova unë, neni 12, bën fjalë që asistent avokati ka të drejtë të bëjë përfaqësime në gjykatë.

*(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Fatmira Luli:* Këtë e mora vesh. Po kush e licencon asistentin?

*Alban Toro:* Dhe kjo është një veprim...





Më duket e kam cituar që ky avokat, ka konfirmuar faktin që ka shërbyer pranë kësaj studio. Ky është avokati kryesor dhe ky shërben...

**Brunilda Kadi:** Më fal Alban. Juve si e vërtetuat që ky zotëria është avokat dhe anëtar i Dhomës së Avokatisë në Greqi? Si e vërtetuat?

**Alban Toro:** Tani, aktualisht ka një firmë dhe një vulë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Ah, kjo është e mjaftueshme që ta vërtetosh?

**Alban Toro:** Avokat. Kam hapur sitin në mënyrë private, kam parë që figuron si avokat.

Duhet t'i bëjë Ministrisë së Drejtësisë greke, për konfirmim?

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Jo, unë thjesht pyeta.

**Alban Toro:** Në qoftë se jeni e mendimit, e shtyjmë dhe i bëjmë dhe Ministrisë Greke.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Ne jemi në fazën që po shqyrtojmë tani relacionin dhe punën që është bërë nga juve. Unë kam një pyetje. Në lidhje me njohjen e ligjit grek.

**Alban Toro:** Më fal se nuk kam mbaruar.

Përpos kësaj, kam parë dhe konfirmimet fiskale që ka bërë pranë autoriteteve greke, ku në klauzolat e saj, është bërë pagesë si për të ardhurat nga ky zotëria, në profesion të lirë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Për kë? Për këtë avokatin?

**Alban Toro:** Jo, jo! Vet individi, kandidati, në kuadër të ushtrimit të profesionit, subjekti, ka bërë deklaram të ardhurash, dhe ka paguar, dhe në kuadratet e përcaktuara në formularin e deklarimeve të autoritetit fiskal grek, është pagesa, dhe poshtë pagesës ka të shkruar "profesion i lirë".

**Brunilda Kadi:** Unë kisha një pyetje në lidhje me legjislacionin. Se tani, të gjithë e njohim procedurën, ne gjyqtarët, juve jeni avokat.

-Si e certifikuat juve përmbajtjen e ligjit grek?



-Kush e përktheu përmbajtjen e ligjit grek?

-Si u certifikua?

-U bë nga një autoritet sipas ligjit përkthimi?

*(Disa nga anëtarët e Komisioni të Zhvillimit të Karrierës përgjigjen pa ndezur mikrofonat që "Nuk e ka marrë akoma".)*

**Brunilda Kadi:** Po atëherë si mund të vazhdojmë të diskutojmë ne këtë gjë?

Pra, pyetja ime është: Në qoftë se nuk e kemi të certifikuar këtë, a ka kuptim diskutimi mbi këtë legjislacionin?

**Alban Toro:** Atëherë, te neni 5, meqenëse e do Bruna, për të drejtën ndërkombëtare.

**Brunilda Kadi:** Neni 5, i kujt?

**Alban Toro:** Ta vazhdoj! Për të drejtën ndërkombëtare private.

**Brunilda Kadi:** Neni 5, i kujt ligji?

**Alban Toro:** I ligjit tonë për të drejtën ndërkombëtare private, 10428, 02.06.2011, kur i referohet gjykatës thotë: "Gjykata njihet kryesisht me përmbajtjen e ligjit të huaj që zbatohet". Dhe pastaj jep dhe forma të tjera se si mund t'i njohësh, në qoftë se i do me detaje, nëpërmjet ndihmës juridike që jep Ministria e Drejtësisë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Ne në çfarë forme e bëmë?

**Alban Toro:** Unë e bëra... Relatori e ka bërë në formë kryesisht.

**Brunilda Kadi:** Alban, kryesisht është e kundërta e asaj që bëhet me kërkesë. Dhe kjo është forma procedurale.

Mënyra se si ti e ke certifikuar përmbajtjen e ligjit grek, cila është nga ato që thotë ligji?

Kryesisht është mënyra se si lëvizte ti. U vure vetë në lëvizje apo të vuri dikush tjetër në lëvizje? Ja ta mbaroj Alban, që ta kuptosh pyetjen.

E kuptova që e ke bërë kryesisht si relator, siç mund ta bëj gjykata.



Tani, cilën nga mënyrat e certifikimit të përmbajtjes së ligjit grek përdore? nëpërmjet ndihmës juridike? Përkthimin ta bëri një autoritet zyrtar, sipas asaj që thotë ligji, një përkthyes i licencuar?

Si e bëre?

Apo thjesht je njohës i gjuhës greke apo nga 'gugëll translejt' (*google translate*)? Si e bëre përkthimin?

*Alban Toro:* Neni 5 i ligjit "Për të drejtën ndërkombëtare private", 10428, i 2011, nuk përcakton që përveç njohjes kryesisht, duhet të bësh edhe metoda të tjera alternative. Në këtë nen, përcaktohet që kur ti, nuk të mjafton pjesa e investigimit kryesisht për legjislacionin e huaj, atëherë ti i drejtohesh instrumenteve të tjera të veçanta, që janë: të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, informacione të siguruar nga Ministria e Drejtësisë, për këtë qëllim mund thirrren ekspertë ose institucione që janë të specializuara.

Personalisht duke mos e njohur...

*Brunilda Kadi:* Alban të lutem! Si e përktheve?

*Alban Toro:* Ta mbaroj moj, ta mbaroj të paktën!

*Brunilda Kadi:* Se nuk po kupton pyetjen. Po të them si e përktheve ligjin grek?

*Alban Toro:* Po ta mbaroj. Aty do dal.

*Brunilda Kadi:* Ah okej! Se ndoshta s'e kupton pyetjen.

*Alban Toro:* Meqenëse më kërkove, ma lidhe pjesën kryesisht me instrumentat. Janë të ndara gjërat. Gjykata e njeh kryesisht. Do të thotë nuk ka nevojë. E njeh, edhe pikë.

*Brunilda Kadi:* Okej. Si e përktheve, Alban?

Kush ta përktheu ligjin grek?

*Alban Toro:* Pastaj, nëse ka nevojë, ka instrumentat.

Unë e përktheva nëpërmjet një të njohurit tim. Pra, e gjeta tek uebsaiti (*website*) i Ministrisë Greke dhe ia dhashë një personi që njeh greqishten.

*Brunilda Kadi:* E kuptova.

*Alban Toro:* Nuk e kam mbaruar, prit. Nuk e kam mbaruar!



Përpos kësaj, është proceduar nëpërmjet stafit të KLGJ-së, që dispozitën përkatëse, jo vetëm këtë, por edhe disa të tjera që kanë rregullime të posaçme në këtë aspekt, ta bëjnë tek një noter i cili disponon një përkthyes të licencuar.

*Brunilda Kadi:* Është bërë kjo ndërkohë?

*Alban Toro:* Është bërë ndërkohë por nuk është mbaruar akoma sepse është material i gjatë.

*Brunilda Kadi:* E kuptova. Tani ju mendoni se është e domosdoshme ky noterimi i përkthimit? Përkthimi i noteruar, është i domosdoshëm për derisa e keni kërkuar?

*(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Alban Toro:* Në qoftë se e kërkojnë. Unë e kërkova...

*Brunilda Kadi:* Jo, jo. Pyetja ime është kjo. Alban të lutem! Ja ta formuloj pyetjen. Nëse ju mendoni që përkthimi që ka bërë miku juaj është në përputhje me ligjin shqiptar, nuk ka kuptim që ne t'i kërkojmë një noteri përkthimin e legalizuar, -është njëra pikë.

Nëse juve mendoni që është e nevojshme përkthimi me noterim, -unë mendoj që s'ka vend vazhdimi i diskutimit sepse duhet të na certifikohet përkthimi. Tani, ndaheni ju si relator. Në qoftë se ju thoni, unë jam okej me përkthimin e mikut tim, hajt ta hedhim në votë dhe ecim për këtë pjesë procedurale. Se tani këtu kemi të përzierë procedurën me materien. Ndaheni njëherë juve si relator.

*Alban Toro:* Personalisht jam i sigurt për përkthimin që ka bërë miku im.

*Brunilda Kadi:* Po mirë pra, po ju jeni avokat.

*Alban Toro:* Proceduralisht, le ta vendosi Këshilli se si do ta ndajë.

*Brunilda Kadi:* Mund ta vendosë një organ publik shqiptar, të marrë një vendim, mbi bazën e një legjislacioni të përkthyer nga miku i vetë, sado njohës i mirë i gjuhës të jetë? I lejohet autoritetit publik shqiptar ta bëjë këtë gjë?

*Alban Toro:* Autoriteti publik shqiptar, siç vepron gjykata, mund ta njohë kryesisht, nëpërmjet faqes publike ku është shpallur ky ligj.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Përkthimi, përkthimi, Alban tani.



**Alban Toro:** Kjo është e para. Në raport me njohjen.

**Maksim Qoku:** Ne kemi pasur një ligj të mëparshëm, 3960, të '68-ës, të '64-ës po që ndryshon në '68-ën, dhe dispozita e atëhershme ka qenë shumë e ngushtë. Pra, lejonte vetëm komunikimin zyrtar, domethënë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë homologe, ku të vinte e kodifikuar dhe e legalizuar nga ministria.

Tani neni 5, solli këtë dispozitën liberale, që e quajmë ne, dhe e rriti hapësirën e marrjes së dokumentacionit. Çka do të thotë, kur thotë termin "gjykata njihet kryesisht", jurisprudence botërore, në fakt jurisprudenca, i ka njohur mundësinë gjykatës, që po, të hyjë ta gjejë, se ka disa faqe legale, zyrtare, që janë zyrtare, dhe mund ta marrësh dhe e ke të konfirmuar. Aq më tepër për vendet e rajonit është e mundur që ne të hyjmë në ministrinë përkatëse, në kodifikim.

Tani problemi është përdorimi i kësaj në territorin që është ligji shqiptar.

Ligji shqiptar ka kriterin *lex loci actum*, pra ligji i vendit ku pranohet akti ose hartohet akti. Në këtë rastin konkret ne na lindë për detyrë që ose palët, ose personi, pra pala që e pretendon, ose kryesisht gjykata, do të duhet që një nga format e legalizimit, që të mund të përdorë. Prandaj dhe është i detyrueshëm përkthimi dhe noterizimi i atij përkthimi vetëm për arsye që marrja e provës në mënyrë ligjore, kërkohet nga ligji shqiptar në këtë formë, kjo është logjika. Pastaj mund të merret po nga ministria jonë e drejtësisë, sipas mënyrës së vjetër, mund të merret dhe nga teksti ndërkombëtar i konventave, nëse shteti grek dhe shteti shqiptar prekin ndonjë rregullim të kësaj natyre me një normë konvencionale e cila dhe është e drejtpërdrejtë, se e thotë dhe Kushtetuta, është marrëveshje ndërkombëtare. Prandaj është noterizimi i nevojshëm, vetëm për këtë arsye besoj.

**Brunilda Kadi:** Mirë, meqenëse po bëjmë diskutim teorik për nenin 5.

E para, unë e sqarova, dhe ndoshta Albani nuk më kupton, por fjala "kryesisht" nuk ka lidhje me mënyrën se si ti e përkthen aktin. Fjala "kryesisht", ka të bëjë me procedurën e gjykatës, pra vihet vetë në lëvizje apo e vë subjekti në lëvizje, dhe vihet pikë. Tani mbasi vihet në lëvizje gjykata, mënyrën sesi ajo e lexon ligjin, vazhdon fjalia e dytë, dhe thotë: "Përveç instrumentave tradicionalë, konventat dhe informacionet që merr



nga ministria, për këtë qëllim, pra që gjykata të njohë përmbajtjen e ligjit, mund të thirren ekspertë. Pra i thotë ose shko nga konventa ndërkombëtare që i ke të botuara në Fletoren Zyrtare dhe i ke në shqip, ose ndihmohesh nga Ministria e Drejtësisë, ose thërret ekspertë. Pa, nuk ta le ty që t'i thuash një mikut tënd: Mos e njeh ti mirë këtë gjuhën dhe më ndihmon mua? Dhe ti ke shumë besim te ai miku. Nuk ta lë ligji ty këtë, dhe nuk ka logjikë që ta njohë. Pra ti, mbasi e vendos kryesisht të njihesh me përmbajtjen e ligjit, o i drejtohesh ministrisë, o e shikon në Fletoren Zyrtare, o merr ekspert. Njërin nga këto të treja, pyeta cilën keni bërë? Unë kështu e lexoj nenin 5.

**Alban Toro:** Kur s'e njeh kryesisht, si do e marrësh pastaj? Për çfarë do ta kërkosh ekspertin?

Jo pra se e interpreton keq. Nuk interpretohet ashtu.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Në momentin që vihem në lëvizje, unë si do ta bëj përkthimin?

**Alban Toro:** Në momentin që gjykata kryesisht nuk i mjafton përkthimi, i drejtohet instrumentit tjetër. Megjithatë ky është moment procedural dhe unë i kam marrë masat që edhe proceduralisht, nëse stafi do ta sjelli në kohë, në mbarim të kësaj seance, okej ta vëmë disponibël. Në rast të kundërt, po do të duash, vendosni për ta shtyrë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Alban Toro:** Tani është dokument që kërkon kohë për t'u përkthyer.

**Brunilda Kadi:** Po është i rëndësishëm Alban dokumenti, sipas vlerësimit tuaj, ne e ndërpresim këtu dhe presim. Nëse nuk është i rëndësishëm vazhdojmë me momentet e tjera. Se mund të kemi edhe pyetje të tjera.


**Alban Toro:** Për mua është i mjaftueshëm. Nëse ju e konsideroni jo të mjaftueshëm...

**Brunilda Kadi:** Okej, dakord.

**Alban Toro:** Mund të vazhdojmë me momentet e tjera, po të kemi pyetje.

**Fatmira Luli:** Kam dhe unë një pyetje tjetër.

Në praktikën e disa muajve, në të cilën kemi kaluar disa kandidatë rresht, ne kemi vepruar kur kandidati ka ushtruar profesionin e avokatit, i jemi drejtuar gjithmonë,



komisioni ose relatori, i është drejtuar gjithmonë me shkresë Dhomës së Avokatisë, dhe keni kërkuar informacion: është licencuar, s'është licencuar, ka paguar taksa, s'ka paguar, të tëra këto; dhe këtë e kemi bërë me kandidatin duke iu drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, dhe kemi marrë një përgjigje që ka marrë një licencë në 2006-ën, por ka qenë pasiv dhe nuk e ka ushtruar asnjë ditë aktivitetin. Pse nuk e kemi bërë të njëjtin gjë për të kërkuar konfirmim nga Dhoma e Avokatisë greke, për të konfirmuar nëse ky zotëri ka bërë shërbim avokatie atje apo jo, sepse i vetmi institucion që të legjitimon dhe të vërteton është institucioni shtetëror. Nuk ka në asnjë vend të botës, ushtrim aktivitet avokatie pa dhënë licencë dhe miratim nga organi kompetent.

*Alban Toro:* Atëherë, në aspektin e brendshëm është bërë pranë Dhomës tonë të Avokatisë për disponimin që ai ka pasur për licencimin e 2006-ës. Duke qenë që kemi të bëjmë me elementë të huaj, do të thotë periudha e aktivitetit të këtij zotërisë, është rregulluar nga një legjislacion i huaj, i jam referuar legjislacionit të huaj. Dhe në kushtet kur legjislacioni i huaj e ka trajtuar figurën e asistent avokatit të njëtrajtshme me avokatin, për ca shërbime të caktuara, s'e kam parë të nevojshëm t'i drejtohem Dhomës së Avokatisë greke, për hetime të mëtejshme, sepse kam pasur konfirmimin nga fisku grek dhe njëkohësisht nga zotëria që e ka supervizuar dhe e ka pasur si mentor në punën e tij si avokat. Kjo është e gjitha.

*Fatmira Luli:* Unë s'jam dakord me këtë. Për shkak se ligji nuk tregon në asnjë rast se kush i licencon dhe kush i regjistron, kush mban listën e avokatëve në shtetin e huaj. Tregon vetëm shërbimet nëse, sa u referua këtu, tregon vetëm shërbimet që kryen asistent avokati. Kështu që e njëjta praktikë, siç është vepruar, kur është dashur të merret informacioni i është drejtuar pedagogut në Zvicër, t'i kërkohej një informacion edhe Dhomës së Avokatisë greke ose Ministrisë së Drejtësisë, në qoftë se e ka kompetencë, për të parë listën, nëse ky zotëri ka punuar atje dhe ajo që është më e rëndësishme që përmendet këtu, ai nuk ka fiskun, por ka një deklaratë të të ardhurave që ka bërë nga viti 2004 deri në vitin 2009, deklaratë e cila është e njëjtë për periudhën që pretendohet që ka punuar si avokat 2003-2004, në tarifa ndoshta dhe më të ulëta se sa periudha që ka punuar asistent avokat. Dhe tarifat janë aq qesharake sa që s'mund të jenë e ardhur nga



puna, sepse pagesa më e madhe, deklarimi më i madh, është . për një vit, për 2004-2005. Të tjerat janë në vit, në vit, në vit, të ardhura këto që s'mund të jenë kurrë të ardhura nga puna. Kjo është një deklaratë e thjeshtë që bëhet për çdo shtetas i huaj në vendin e tij për të ardhurat që ka pasur gjatë një viti. Nuk është vërtetim pune ose llogari bankare për të vërtetuar që ai ka pasur të ardhura nga kjo punë dhe ka punuar.

*Brunilda Kadi:* Atëherë thuhet, nga ana... Më shumë e kam me procedurën, se pastaj diskutimi i materies është tjetër gjë.


Sipas relacionit thuhet: "...referuar komunikimit në rrugë elektronike numër, datë, nga avokati filan, thuhet që ka punuar në zyrë për periudhën 01.10.2003-30.11.2005".

Nga relacioni duket që diplomën e parë të baçelorit (*bachelor-it*) subjekti e ka marrë në shkurt të 2004-ës. Sipas ligjit grek që juve e kishit të përkthyer, dhe e besuat përkthimin, mund të punosh jurist pa pasur titullin "jurist" sepse nga dokumentat që ishin formale, dhe unë kam diskutime dhe pyetje edhe për anën formale të dokumentacionit dhe mënyrën se si sillen ato para autoriteteve shqiptare, por në hipotezën që provohet ky fakt nga ana formale, mund të punosh jurist sipas ligjit grek, kur nuk ke marrë titullin "jurist"?

*Alban Toro:* Atëherë, nëse do të ishte e vëmendshme në komunikimin që kam patur me një nga kolegët tanë, i cili ka patur të njëjtin problem, për të kuptuar këtë paqartësi që kishin dalë nga aktet, është e vërtetë që certifikata e juristit është lëshuar në shkurt të 2004-ës, provimi me nota "shumë mirë" është marrë në dhjetor 12.12.2003, dhe konform nenit 3 të ligjit grek, pra Kodin e Avokatisë, për të ushtruar funksionin e avokatit duhet të kesh marrë titullin "jurist" dhe të punosh pranë një studio avokatie. Këtë ka ligji grek për asistent avokatin.

*Brunilda Kadi:* Jo, jo.

*Alban Toro:* Dhe zotëria është certifikuar si jurist në 12.12.2003. Ka marrë provimet. Certifikata ka një hapësirë kohore që nuk jepet në moment, por kalohet një kohë, nuk e di për çfarë arsye, për betimin a nuk e di, dhe zotëria merr certifikatën ku konfirmohet që ai është konfirmuar si jurist në 12.12.2003.





*Brunilda Kadi:* Në sa?

*Alban Toro:* 12.12.2003.

*Brunilda Kadi:* Edhe sikur të jetë kështu, që unë kam diskutimin tim, përsëri nuk më kombinojnë faktet sepse ti thua 12.12.2003, ndërkohë ky avokati thotë që ky ka filluar punë që në 01.10.2003, pra 2 muaj përpara se të jepte dhe këto provimet e fundit.

*Alban Toro:* ...në vlerësimin e zotërisë, pra nga përvoja, duke konsideruar këtë si përvojë...

*Brunilda Kadi:* Të lutem Alban, pyetja ishte: Sipas ligjit grek, mundet që ta bëjë ai këtë gjë, pra pa dhënë provimet, të punojë si jurist? Kjo ishte pyetja ime. Sipas ligjit grek.

*Alban Toro:* Atëherë, si asistent avokat, zotëria bëhet në momentin kur ai ka mbaruar dhe ka marrë notat e duhura për të marrë juridikun. Që do të thotë, në 12.12 zotëria është asistent avokat. Se si ka preferuar zotëria ta marri në atë kohë, pak rëndësi ka për mua, sepse unë si relator e kam konsideruar nga 12.12.2003, po të doni e bëjmë dhe nga shkurti kur i është dhënë certifikata, pak rëndësi ka për përvojën sepse e plotëson, janë punë muajsh, 2 muaj, pra nuk besoj se është e rëndësishme, e rëndësishme është që ky të jetë jurist. Nëse ka dhe për këtë konflikt, që a është jurist...

*Brunilda Kadi:* Okej, po ky komunikim, nuk ju vë juve si relator në dyshim që si ky avokati që ju e kenë njohur nga uebsajti (*website*) dhe e kishit gjetur që është avokat, zotëria dhënka një vërtetim, që i vihet në dyshim, informacioni që jep, sepse ai pa qenë jurist ka punuar jurist, dhe sipas ligjit grek që ju e njihnit, që e kishit përkthyer, ai nuk mund ta bëjë këtë gjë, po mos ka marrë diplomën.

*Alban Toro:* Edhe njëherë që mos i ngatërrojmë gjërat. Si asistent avokat ai nuk mund të punojë nëse nuk ka marrë diplomën. Si jurist pastaj është preferencë e zotërisë ta marri, ta punësojë, nëse e konsideron që është i aftë, pak rëndësi ka.

*Brunilda Kadi:* Ligji grek ca thotë për juristët?

*Alban Toro:* E kam hulumtuar për asistent avokatin, jo për juristin.

*Brunilda Kadi:* Po si e përktheni ju që ka qenë asistent avokat, kur vërtetimi thotë jurist?



*Alban Toro:* Ai është legal officer dhe më poshtë thotë që më ka ndihmuar në praktikat e mia në të drejtën civile, administrative, etj., siç janë aktet.

*Brunilda Kadi:* Me çfarë të drejte juve kenë interpretuar fjalën e këtij avokati që ai thotë "jurist", kurse juve thoni "asistent avokat", si e bëtë këtë ekuivalentimin? Me çfarë bazash? Nga përkthimi apo nga njohja e ligjit grek? Këtë dua të kuptoj.

*Alban Toro:* Nga veprimet aktive që ka kryer zotëria, nga aktet që rezultojnë aty dhe nga autoriteti fiskal përkatës, ku konfirmohen të ardhurat që ky ka paguar.

*Brunilda Kadi:* Pyetja tjetër ishte që: -Si e vërtetoni juve që noteri është avokat në shtetin grek?

*Alban Toro:* Atëherë, për këtë aspekt, përveç shkresës private që ky ka lëshuar, me firmë e me vulë, kam parë dhe në uebsajt (*website*), kam hulumtuar edhe në faqen e internetit.

*Brunilda Kadi:* Pra ju mendoni që nuk ju duhet një dokument zyrtar nga shteti grek që të konfirmojë këtë fakt?

*Alban Toro:* Personalisht, jo.

*Brunilda Kadi:* Dhe që të vij një dokument me vulë apostile?

*Alban Toro:* Personalisht, jo.


*Brunilda Kadi:* Kush është me vulë apostile?

(*Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.*)

Jo, sepse avokati është profesion që regjistrohet diku dhe që ti, si autoritet i një shteti tjetër, të sigurohesh që ky personi është vërtetë ky lloj punonjësi, ta certifikon vetëm autoriteti shtetëror i atij shteti dhe ky është qëllimi i vetëm i vulës apostile.

*Alban Toro:* Shkresa e zotërisë është e përkthyer nga shqipja dhe anglishtja tek noteri shqiptar. ... është në anglisht. Është përkthyer nga nëpunësit tanë këtu.

*Brunilda Kadi:* E mira është që mos përsëritemi, edhe për pjesën e universitetit, sepse unë nuk e kuptoj si ka mundësi që nuk sjell universiteti vërtetim, por e dërgon privatisht profesori. Se në qoftë se ky ka qenë asistent pedagog në një universitet, unë mendoj që këtë vërtetimin duhet ta sjellë ky instituti arsimor.



*Alban Toro:* Atëherë Bruna, ke një vërtetim të lëshuar nga universiteti, ke një vërtetim.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

Ke një vërtetim të lëshuar nga universiteti, ke dhe një komunikim me pedagogen e këtij universiteti që kemi bërë ne nëpërmjet e-mailit, për efekt të masave disiplinore, dhe na ka konfirmuar, të njëjtën gjë na ka konfirmuar.

*Brunilda Kadi:* Universiteti?

*Alban Toro:* Pedagogia, në kuadër të universitetit.

*Brunilda Kadi:* Është me vulën e universitetit?

*Alban Toro:* Po, private.

E-maili është e-mail.

*Brunilda Kadi:* Po ky dokumenti është i certifikuar me vulë apostile nga Ministria e Arsimit?

*Alban Toro:* Është i përkthyer dhe...

*Brunilda Kadi:* Okej!

Komunikimi juaj është bërë në çfarë forme, që keni pyetur për masat disiplinore? Sepse nga njohja e akteve që pashë unë, ishte bërë me e-mail, direkt në gjuhë të huaj, që mendoj që nuk është korrekte sipas procedurës. Sepse sipas ligjit tonë procedural civil dhe administrativ, autoritetet shqiptare komunikojnë vetëm në gjuhën shqipe dhe dokumenti nga institucioni duhet të dalë në gjuhën shqipe. Nëse do niset në gjuhë të huaj, duhet t'i bëhet përkthimi zyrtar nga autoritetet që lejon ligji, pastaj të kalojë gjithë linjat e tjera. Juve e keni bërë në gjuhën shqipe.


Mund të jepni një shpjegim ku jeni bazuar që e keni bërë këtë?

*Alban Toro:* Po me ndihmën e kolegëve që e njohin shumë mirë anglishten, e kanë përkthyer pjesën shqip në anglisht dhe kam proceduar duke e dërguar me e-mail.

Pjesa e përkthyer shqip...

*Brunilda Kadi:* Okej.

Po për kolegët që nuk janë shumë të mirë në gjuhën angleze, si do certifikohet përmbajtja e dokumentit?



*Alban Toro:* Po të kesh durimin të më dëgjosh deri në fund, do e kishe dëgjuar dhe këtë. Për pjesën anglisht e cila është dërguar zonjës në fjalë, është proceduar me përkthimin dhe disponimin e asaj kopje në dosje nga stafi i KLGJ-së, i cili njihet për këtë pjesë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Alban Toro:* Një përkthyes te Drejtoria Juridike që merret me këtë punë, që përkthen materialet tona në uebsaite (*website*), ku e di unë ç'a bën.

*Brunilda Kadi:* Pra ai na i certifikon këtë gjë ne sipas ligjit?

*Alban Toro:* Ai ka përkthyer, ka njohje, në qoftë se do t'i nxjerrim...

*Brunilda Kadi:* Okej, mirë.

Atëherë unë kam edhe dy pyetje të fundit.

Sipas jush, por dhe fatmirësisht sipas kompozimit që ka Këshilli, ne mund të pyesin drejtpërdrejtë, relatori është avokat, kemi dhe një avokat tjetër anëtar, dhe dy profesorët. Asistent avokat, dhe në hipotezën që provohet se subjekti ka ushtruar këtë detyrë, a është baras me juristin e spikatur që duhet të jetë avokat sipas Kushtetutës?

Pyetjen e kam për relatorin që është avokat, për zonjën Luli që është avokate, dhe po kështu, e njëjta pyetje është dhe për dy anëtarët e nderuar profesorë, të nderuar janë edhe anëtarët e tjerë, më falni se ndoshta nuk u shpreha korrekt. Kam të njëjtën pyetje. A është asistent profesori baras me profesorin?

*Alban Toro:* Dëgjo!

Problemi në fjalë është ligjor dhe secili e interpreton ligjin në mënyrën se si e interpreton ai. Nëse do interpretimin tim si ia kam bërë ligjit, atëherë po të them këtë.

Në kushtet kur ligji grek e njeh asistent avokatin, nga prezenca aktive që merr pjesë në shërbimet që ofron, për të tretët, në kuadër të mentorit të tij, e njeh si veprimtari të mirëfilltë avokatie. Ligji shqiptar, ligji "Për avokatinë", 55/2018, në nenin 4, bën të njëjtën gjë, që ia lejon rregullimit të këtij aspekti, ligjit ku ai ushtron aktivitetin. Dhe në këtë aspekt e kam konsideruar si përvojë avokatie.

*Brunilda Kadi:* E ke interpretuar. Se po flisje, e nise me interpretimin e ligjit. E ke interpretuar që asistent avokati në Shqipëri...



*Alban Toro:* Më kërkove interpretim ligji, s'më kërkove a e kam.. . Se provat janë në dosje. Provat janë në dosje. Më kërkove interpretim apo përvojë?

*Brunilda Kadi:* Sepse përdore fjalën "e kam konsideruar".

*Alban Toro:* Po pra e kam interpretuar.

*Brunilda Kadi:* Ke interpretuar që asistent avokati është avokat.

*Alban Toro:* E kam konsideruar/interpretuar, ka ndonjë ndryshim?

Nëse ka ndonjë ndryshim ma thuaj të ndriçohem.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Alban Toro:* Njëllonj.

*Fatmira Luli:* Atëherë, të përgjigjem unë?

Ligji thotë në mënyrë të qartë: Të ketë punuar si avokat. Dhe nuk thotë: Të ketë kryer shërbime avokatie. Ose të ketë dhënë mësimdhënie, kur thotë për profesorin. Është tjetër mësimdhënia dhe tjetër shërbimet e avokatisë, dhe tjetër kur citon në mënyrë eksplicite "avokat", që do të thotë të kesh bërë vetëm punën e avokatit, dhe avokat mundësisht përfaqësimi, sepse bën fjalë për juristë të shquar. Dhe mundësisht avokat, për të theksuar elementin "e shquar", të jesh avokat me përvojë. Ky ka qenë qëllimi i ligjvënësit, kur ka cituar termin "avokat". Jo çdo lloj pune që duhet të vërtetohet që ti je jurist. Por në mënyrë të specifikuar të kesh shërbyer avokat, profesor ose lektor, prandaj ka vënë faktin e të qenit lektor, për ta diferencuar nga një mësimdhënie e thjeshtë që mund të kesh qenë asistent, e të japësh seminare. Kjo është diferenca që bën ligji dhe këtë pjesë të dispozitës ne duhet ta respektojmë.


*Alban Toro:* Të jap një sqarim, nëse më lejoni?

*Brunilda Kadi:* Për avokatin?

*Alban Toro:* Jo, jo! Për pedagogun, se tani dolëm te pedagogu.

*Brunilda Kadi:* Më fal Alban, po kërkova një opinion këtu nga dy profesorët, si e vlerësojnë ata, se besoj që në këtë pjesë janë më të informuar se secili nga ne, kam përshtypjen. Të paktën, de jure.

*Alban Toro:* E doje për avokatin apo për profesorin?



*Erjon Muharremaj:* Atëherë, në lidhje me pyetjen tuaj zonja Kadi, referuar ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në kategorinë “profesor” bëjnë pjesë zotëruesit e dy titujve: profesor i asociuar dhe profesor doktor. Që të dy futen në kategorinë “profesor”. Kuptohet, siç janë gradat në ushtri apo në shërbimin diplomatik, profesori i asociuar është një shkallë më poshtë se sa profesor doktori. Siç janë gjeneralët në ushtri, ka gjeneral major, gjeneral kolonel, por gjithsesi janë gjeneralë, në të njëjtën mënyrë janë caktuar edhe gradat dhe titujt në sistemin arsimor. Faleminderit!

*Brunilda Kadi:* Jo, kur thuhet asistent pedagogu është baras me pedagogun?

Sipas akteve që kemi në shqyrtim, dokumenti që vjen nga  
s thotë: ka asistuar si pedagog.

Pra, “ka asistuar si pedagog”, juve si e përktheni në gjuhën tuaj?

*(Zoti Qoku flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Maksim Qoku:* Ka ushtruar pedagogun.

*(Më pas merr fjalën me mikrofon.)*

Referuar kuptimit të ligjit tonë “Për arsimin e lartë”, sepse dikur ka qenë termi asistent, sot nuk është më asistent pedagog. Nëse thuhet termi “ka asistuar në mësimdhënie”, ne nënkuptojmë atë që në gjuhën e përditshme quajmë “asistent”, por që në fakt janë pedagogët më të rinj të cilët nuk janë lektor të së drejtës, pra që të kenë aftësinë të japin leksione, dhe të japin, tashmë e kemi me sisteme, baçelor (*bachelor*), masteri apo studimet post master, etj., master ekzekutiv që janë sot, por janë të detyruar të japin në sistemin baçelor (*bachelor*), në seminare, apo dhe në praktika brenda këtij sistemi. Këto mund të quhen pedagogë që asistojnë pedagogët e lëndës, sepse është e vërtetë që një lëndë ka një titullar, por mund të ketë edhe disa pedagogë në atë lëndë. Dhe titullari është ai që e ka apriori, përveç titujve, dhe titullin lektor i së drejtës, por që mundet që lektorë të së drejtës të jenë edhe persona që nuk kanë tituj, por që janë në proces doktorature, që është rasti përjashtimor, por doktor e sipër janë dhe lektorë të së drejtës. Ndërsa ata persona që në gjuhën e përditshme i quajmë asistentë, në fakt janë



këta që asistojnë në mësimdhënie, çka do të thotë janë seminaresh apo praktikash brenda sistemit baçelor (*bachelor*), jo më lart.

**Brikena Ukperaj:** Edhe diçka tjetër. Është praktikë e universiteteve, sepse universitetet ndërkombëtare e kanë që një student doktorant, gjatë periudhës që ai ndjek doktoraturën pranë një universiteti (është edhe me ligj), të japë njëkohësisht, të bëhet pedagog ose të jetë asistent i një titullari lënde, pranë së cilit ai ndjek doktoraturën dhe jep seminare ose leksione, ose edhe korrigjon provimet e studentëve... Po pra!

Është e njëjta situatë sikundër dhe një person që nuk është fare në proces doktorature, por është jurist dhe jep seminare në një fakultet. Ai e ka eksperiencën si pedagog. Domethënë ka ndonjë problem në këtë rast?

**Maksim Qoku:** Shiko ku është problemi. Referuar ligjit tonë, sot nuk mund më të emërohesh pedagog po nuk ke titull. Rasti përjashtimor shqiptar ka qenë që personat që kanë qenë me ligjin e vjetër, në procesin e doktoraturës, mund dhe të merreshin pedagog, që ta përfundonin si proces. Tek ne ka marrë vlerë dhe ai që quhej procesi i doktoraturës, që ishte 3-vjeçar, por si rregull me rregullimin e ri, një person në Shqipëri që kërkon të aplikojë dhe të marrë të drejtën për të studiuar në doktoraturë, menjëherë fiton të drejtën e emërimit pedagog, dhe paguhet me gjysmën e pagës së pedagogut, dhe duhet që ndër të tjera, përveç sërçing (*searching*), kërkimit për doktoraturë, të bëjë dhe mësimdhënie. Dhe është nën kujdesin e atij pedagogu mentor që e ndjek në doktoraturë, pra jep në atë lëndë. Sot kjo është situata ligjore në Shqipëri.

Kjo është në gjithë rajonin, se kështu e kemi ne.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, sipas përmbajtjes së dokumentit, të

thuhet: "Pas përfundimit të studimeve të doktoraturës ka asistuar si pedagog", dhe bën fjalë për 2005-2009. Ju po thoni që ai ka marrë titullin "doktor" në 2011. Po si e shikoni këtë përmbajtjen e...?

**Alban Toro:** Është pedagog pra.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Pas përfundimit të studimeve të doktoraturës, pra flet për ka asistuar si pedagog. Pra, unë në gjuhën shqipe, këtë e kuptoj që subjekti, në 2005-ën, e kishte mbaruar doktoraturën.



*Alban Toro:* Ka mbaruar... pas studimeve, - thotë, dhe provimi jepet një moment të dytë.

*Brunilda Kadi:* Jo, jo! Pas përfundimit të studimeve, - të lutëm, se unë po lexoj atë që keni sjellë ju në relacion. Si e kuptoni ju fjalën "pas përfundimit të studimeve të doktoraturës".

*Alban Toro:* 2005-2009 ka mbaruar provimet për t'u përgatitur si doktor dhe provimet i ka dhënë në 2011. Çfarë problem ka?

*Maksim Qoku:* Edhe në na ka ndodhur kjo.

*(Zoti Qoku flet pa ndezur mikrofonin.)*

*Brunilda Kadi:* Po t'i themi, se do marrim vendimin.

*Maksim Qoku:* Problemi është që, "doktori" është gradë dhe grada lidhet me një procedurë specifike. Fillon në fillim Shkollën Doktorale.

*Naureda Llagami:* A flasim të gjithë me radhë tani që t'i kuptojmë gjërat. Të lutem.

*Maksim Qoku:* Shkolla doktorale, sepse "Doktori" është gradë, dhe ka disa kushte më rënduese se titujt e tjerë. Shkolla doktorale ka një hapësirë ose një kohëzgjatje trevjeçare. Por mund ta bësh dhe katër vjet e pesë vjet. Mbasi mbaron shkollën, do të mblidhet komisioni i profesorëve dhe do të caktojë datën e mbrojtjes, titullin për marrjen e gradës "doktor".

Problemi është që mund të ndodhë që për t'u caktuar kjo datë duhen dhe vite.

Në rastin tim konkret për shembull, nga 2006, unë e mbrojta doktoraturën në 2009-ën, 3 vjet u desh, se duhej matrikulimi, gjetja e profesorëve... isha që në '95-ën ... Matrikulimi, gjetja e profesorëve, azhurnimi i bazës ligjore të vjetër, nxjerrja e VKM-së dhe bëri që pavarësisht që unë e kam mbaruar në 2000-2003 masterin, i nivelit të dytë në atë kohë, unë doktoraturën e kam mbrojtur në 2009. Gjithë këto vite unë ndenja pezull por e kisha mbaruar shkollën e doktoraturës, se kisha mbrojtur të gjithë provimet. Prandaj krijohet një shkoputje midis momentit kur unë marrë gradën doktor me atë certifikatën ku unë marrë gradën përpara një komisioni dhe momentit kur kam bërë tre vjet shkollën. Dhe për kushtet e Shqipërisë, kjo ka ndodhur dhe për 2-3 breza pas meje, që vazhduan në



të njëjtën mënyrë, sa pa u hapur shkolla doktorale. Sepse kur u hap shkolla doktorale, u mundësua që të ishte shumë efektiv komisioni i profesorëve, i cili në momentin që do të arrinte kush nga studentët përfundonte shkollën bënte dhe një program për caktimin e datave për mbrojtjen. Se është një procedurë shumë... prandaj them dhe që kjo ka kuptim.

*Alban Toro:* Bruna, shkresat e thjeshta nuk i ke me apostil, pjesa tjetër është e noterizuar, e legalizuar.

*Brunilda Kadi:* Dokumentat nga Zvicra i kishe me apostil.

*Alban Toro:* Nga Zvicra i kishe të përkthyer, të noterizuar.

*Brunilda Kadi:* Okej. Po nga shteti grek vetëm 3 dokumenta ishin me apostil.

*Alban Toro:* Jo i ke me apostil. Legjislacioni... fiskalja ishin me apostil.

*Brunilda Kadi:* Vetëm dokumentat fiskale ishin me apostil. Po komunikimet me universitetin, nuk ishin.

*Alban Toro:* Është shkresë e thjeshtë. S'besoj se duhet.

*Brunilda Kadi:* Universiteti nuk është institucion, edhe po të jetë privat, është përsëri i miratuar nga Ministria e Arsimit. Përveçse mund të jetë Ministria e Arsimit a nuk e di çfarë ministrie mund të jetë përgjegjëse në shtetin grek. Por po e them kështu në mënyrë të përgjithshme.

*Brikena Ukperaj:* Mund të shtoj diçka kryetare?

Tani duke qenë se këtu u ngritën pretendime lidhur me plotësinë e procedurës, dhe nga ana e Komisionit ne kemi një relacion dhe vendimmarrja e komisionit duhet të ketë qenë që procedura ka qenë e plotë, pa u shprehur lidhur me plotësinë apo jo të kësaj procedure, nuk mund të kalojmë dot në shqyrtimin e propozimit që mund të bëjë relatori. Kështu që fillimisht duhet të votojmë nëse procedura e verifikimit është e plotë apo jo dhe nëse nuk është e plotë, çfarë aktesh janë të nevojshme që duhet të merren.

*Naureda Llagami:* Po, zoti Toska!

*Ilir Toska:* A tëherë, nga të gjithë debate që ndoqa deri tani mes kolegëve, kam evidentuar disa momente ku nga anëtarë është konsideruar që do duhet të marrim disa konfirmime në mënyrë tjetër apo shtesë.



vërtetohen këto sipas jush, ushtrimi i këtyre detyrave, nuk thuhet që ai është paguar për shembull X lekë. Lidhja besoj që gjendet në çdo shtet. Mund të merret një vërtetim ose lekët që janë paguar në bankë, të përputhen për shembull pagesat.

*Marçela Shehu:* Me sa kuptoj, kërkoni një vërtetim nga universiteti ku ka qenë asistent pedagog, që të vërtetojë që është paguar si asistent pranë këtij subjekti? Po pra, që ju të verifikoni lidhjen midis të ardhurave dhe institucionit.

*Brunilda Kadi:* Sepse unë mendoj që përvoja profesionale është e vlefshme dhe nëse ai mund të bëjë punë pa pagesë, subjekti. Nuk është e thënë.

Se mund të jesh avokat që punon në një institucion bamirësie, dhe përsëri ty të quhet përvojë profesionale.

Por lidhja që e bën relatorin për të certifikuar vërtetësinë e asaj që thuhet tek vërtetimet private, e lidh me këto dokumentat fiskale, lidhje të cilën unë nuk e gjej.

*Alban Toro:* Po profesioni i lirë, përveç asistent pedagog, çfarë mund të jetë tjetër për shembull?

*Brunilda Kadi:* Profesioni i lirë, - se tani nuk dua të flas.

Psikolog.

*Alban Toro:* Psikolog?

Formimi është jurist.

*Brunilda Kadi:* Dentist.

*Alban Toro:* S'besoj që për psikolog mund të merret një...

Ti nga një anë ke të autoritetet fiskale deklarimin, nga profesionet e lira për pagimin e..

*Brunilda Kadi:* Profesioni i lirë është "avokat".

*Alban Toro:* Po të tregoj dhe marrëdhëniet e punës që ka lidhur me studion legale përkatëse.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në votim çështjen që a do hapet hetimi, procedura, a nevojiten prova shtesë lidhur me relacionin e përgatitur?

A kemi nevojë për prova shtesë, ashtu sikurse u referua nga kolegët? Po apo jo?

Jeni dakord me...?



*Fatmira Luli:* Të them unë diçka?

Është shumë e rëndësishme kjo, verifikimi i kësaj, sepse ai i bie ditë më ditë. Në 2004 të jetë diplomuar dhe atij i bie rreth 5 vjet pune, që në qoftë se nuk vërtetohen zyrtarisht, ai nuk plotëson kriterin 15-vjeçar.

*Naureda Llagami:* Fatmir, keni 40 minuta që diskutoni dhe nuk po diskutojmë më.

Ne tani po kalojmë në anë... të lutem. Po kalojmë proceduralisht.

Në qoftë se ne do vazhdojmë me seancën, do duhet të kalojmë proceduralisht. Jemi dakord që të hapet hetimi lidhur me subjektin për të kërkuar prova shtesë për sa u diskutuan këtu?

Hedhim në votim hapjen e hetimit lidhur me subjektin.

*Maksim Qoku:* Po për sa i shërben sqarimit dhe aq më tepër cilësisë së vendimmarrjes tonë, jam dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Kundër.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Kundër.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë mundet që t'i përcaktojmë këtu sepse kjo është një procedurë e gjatë dhe unë do të doja shprehimisht, ne t'i përcaktojmë këtu cilat janë provat dhe mënyra se si duhet t'i marrim këto prova, në mënyrë që në momentin që nga ana e relatorit të disponohet me provat, të paraqesim kërkesë për mbledhje, për ta futur në rend dite sepse po humbasim shumë kohë lidhur me pjesën e procedurës.

Po, zoti Toska!



*Ilir Toska:* Janë dy mundësi, o t'i kërkojmë ne vetë ato ose t'ia kërkojmë kandidatit për të gjitha këto çështje të na paraqesë këto konfirmimet që ne konsideruam.

Më operative është t'ia kërkojmë kandidatit që të vërtetojë kushtet.

*Brunilda Kadi:* Po ai i di ku janë që t'i marri shpejt.

Po gjithsesi duhet ti citojmë.

*Ilir Toska:* Atëherë e vetmja gjë që unë s'citova ishte ajo që tha Bruna më pas, për sa i përket tatimeve të paguara në shtetin grek për periudhën...

*Brunilda Kadi:* 2003 fillon.

*Brikena Ukperaj:* Ideja është që në qoftë se ne do t'i kërkojmë universitetit zyrtarisht të dhëna që mblidhen lidhur me veprimtarinë që ka ushtruar gjatë periudhës së doktoraturës në universitet, pra çfarë ka bërë, ka dhënë leksione apo ku konsiston kjo veprimtari, mund të kërkojmë informacion nëse është paguar nga universiteti për këtë lloj veprimtarie sepse paralelisht kandidati ka marrë dhe bursë nga shteti për këtë punë. Këtë mund t'ia kërkojmë, pavarësisht mënyrës se si do ta çmojmë pastaj, nëse pagesa vërteton kryerjen e veprimtarisë, kjo është pastaj diçka tjetër.

*Brunilda Kadi:* Unë e thashë në fund të diskutimit tim, pra ai nuk është e thënë të paguhet që t'i quhet përvojë profesionale, unë thjesht dua të bindem zyrtarisht që vërtetimi ka qenë në këto dy detyra, sepse për mua, e thashë që në fillim, që të mos e përsërisim, sjellja në mënyrë private e vërtetimeve nga profesori dhe ky avokati, zotëria nga Greqia, duhet të vijë sipas procedurës që e diskutuam dhe më përpara. Kështu që, për mua nuk është e nevojshme të bëhet lidhja mes tatimeve dhe shkollës për aq sa provohet pastaj bindshëm që ka qenë te shkolla dhe avokatia.


*Ilir Toska:* Pyetja ishte, - A do duhet të konsiderojmë përkthimin e ligjit të arsimit të lartë të shtetit grek?

Avokatisë e thashë. Në një moment po bëhesh debat...

(Ndërhyjnë anëtarët e tjerë.)

*Marçela Shehu:* Përkthimin në kuptimin, më fal Ilir. A nevojitet përkthimi për të vlerësuar nëse asistent pedagogu ka të njëjtin kuptim me lektorin?

*Maksim Qoku:* Thotë, ka asistuar si pedagog.



*Marçela Shehu:* Po pra, por ne jemi të qartë sipas ligjit tonë, apo jo?

A nevojitet, sikurse e kërkuam përkthimin e ligjit grek për avokatinë apo është e mjaftueshme vetëm kaq?

*Ilir Toska:* Cilësova këto gjëra që dolën:

Konfirmimin nga ana e avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e avokatisë.

E dyta është konfirmim nga universiteti grek në lidhje me veprimtarinë për asistimin apo për asistent pedagog dhe konsiderimin e saj të qenies lektor, në kuptim të ligjit shqiptar, se me kemi fjalën lektor në Kushtetutë dhe në ligj.

Dhe e fundit do të ishte, nga universiteti në Zvicër, për sa i përket kërkimeve shkencore gjatë periudhës që i referohet.

*Naureda Llagami:* Edhe një merak tjetër kam unë. Duke qenë se neve tani do e shtyjme seancën për të marrë këto, kemi çështje të tjera - sepse jemi fut në seancë për shqyrtimin e këtij rasti - kemi çështje të tjera për të cilat neve mund të kërkojmë informacione të tjera? Pra në qoftë se ky është kriteri i parë që ne kemi, po ekzaminojmë, për pjesën tjetër, se nuk mund të shkojmë në një seancë tjetër pas tre javësh dhe të themi, duam edhe një dokument tjetër, se raportin ne e hapëm dhe e morëm në shqyrtim. Një nga problematikat që ne konstatuam është se kërkojmë informacione lidhur me pjesën e kriterit të përvojës.

Tani, po për pjesën tjetër kemi diskutime? Sepse është shumë e rëndësishme që lidhur me pjesën e menaxhimit edhe të seancave pasi s'mund ta shtyjme infinitivisht për secilin...

*(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)*

Atëherë, lidhur me çështjen e parë, lidhur me shqyrtimin e çështjes së parë do të shtyhet në një seancë tjetër, në momentin kur relatori të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga anëtarët e mbledhjes dhe do na bëjë me dije në momentin që janë gati që ta fusim në rend të ditës urgjent.

Dakord?

Shtyhet edhe shqyrtimi i...

Bëjmë 15 minuta pushim dhe vazhdimi i seancës plenare do vazhdojë nga Zëvendëskryetari për shkak të një angazhimi timin në këtë momente.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Dllagani



Specialiste

Rosalba Xhabrahimi